
AKT THEMELIMI
i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“Luxury Diverse” SH.P.K.

Sot, me 04.07.2022, une e nenshkruara: Elona Çaushi e datelindjes 24.05.1971 e pajisur me karten e identitetit H15524060L, regjistroj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Luxury Diverse” Sh.p.k.,

Neni 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e saj te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijojë Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “Luxury Diverse” Sh.p.k., me kapital themeltar 100 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Brigada VIII, Pallati Nr. 2, Shkalla 3, Kati 0

Ortaku i kesaj shoqerie do te jete Elona Çaushi dhe administratore Ina Reçi.
Shoqeria “Luxury Diverse” Sh.p.k., ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithë ortaket e saj.

Neni 4

Objekti i shoqerise : Shitje me pakice produktesh kozmetike dhe parfume, produkte luksi. Gjithashtu shoqëria mund te ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 000 leke te ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000 leke per kuote ku:

Elona Çaushti zoteron 100% kete kuote me vlere 100 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga aksionaret ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimet te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Biznesit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 7

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 8

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

Neni 9

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.


Neni 10

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

Themeluesi pas leximit me kujdes Aktin e Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e saj.

Administratore

Ina Reçi

Ina Reçi


Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues:

Elona Çaushti

Elona Çaushti
